

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN, gjyqtari Refki Piraj, me procesmbajtësen Halime Nixha sekretare juridike e kësaj gjykate, në lëndën penale kundër te pandehurve B. R. nga Prizreni dhe D. R. nga Prizreni, te akuzuar sipas aktakuzës së PTH ne Prizren PP/II.316-3/17 te dt 02.05.2017, dhe marrëveshjes për pranimin e fajësisë PP/II.nr.316-3/17 te dt. 28.04.2017, për shkak të veprave penale te vjedhjes se rende nga neni 327 par.1 nen par.1.1 lidhur me nenin 31 dhe 28 te KP, si dhe lidhur me nenin 81 te KPP së, në prezencën e të akuzuarve dhe mbrojtësve av. G. K. me autorizim si dhe av.Z. K. i caktuar sipas detyrës zyrtare, prokurorit te shtetit Sahide Sefa, më dt.11.05.2017 mur dhe publikisht shpalli këtë:

AKT GJYKIM

Te pandehurit :

B. R. i lindur me ne Prizren, me banim ne rr. nga i ati F. dhe e ema G. e lind. I. ka te kryer shkollën fillore, i pa martuar, punëtor, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar shtetas i R. te Kosovës.

D. B. i lindur ne Prizren, me banim ne rr. nga i ati F. dhe e ema F. e lind. S. ka te kryer shkollën fillore, i pa martuar punëtor, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar shtetas i R. te Kosovës.

JANE FAJTOR

-Se në vazhdimësi

I. Më datën 25.01.2017 rrëth orës 07:15 min ne Prizren ne rrugën " " ne marketin " ", me qellim te përvetësimit te kundërligjshëm per vete ia marrin pasurinë e te dëmtuarit S. T. ne ate mënyre qe përdorin forcën dhe me mjete te forta këpusin telat e rrithojës dhe drynin e derës se marketit, hyjnë brenda dhe nga aty marrin cigare te llojeve te ndryshme, te cilat me pas i fshehin ne një shtëpi te pabanuar, dhe largohen nga vendi i ngjarjes.

Këso dore kane kryer veprën penale vjedhje e rende nga neni 327 par.1 nen paragrafi 1.1 lidhur me nenin 31 te KP-së.

II.me datën 31-01.01.2017, ne kohe te pa përcaktuar, ne Prizren, ne rrugën "Jusuf Gervalla" me qellim te përvetësimit te kundërligjshëm për vete ose personin tjetër, ia marrin pasurinë e te dëmtuarit – bankës "Wester Union" ne ate mënyrë, qe me përdorimin e forcës prejnë xhamin e derës se lokalit, hyjnë brenda dhe nga aty marrin kacen e hekurit dhe 115 euro, dhe largohen nga vendi i ngjarjes.

Këso dore kane kryer veprën penale vjedhje e rende nga neni 327 par.I lidhur me nenin 31 te KP-së.

36

III.me datën 14-15.01.2017, ne kohe te papërcaktuar, ne Prizren, ne rrugën "Tirana" tek ndërtesat e "Fat Grup", me qellim te përvetësimit te kundërligjshëm per vete ose personin tjetër, ia marrin pasurinë e te dëmtuarit V^{..} M^{..}, ne ate mënyrë qe me përdorimin e forcës thyejnë derën e automjetit te markës "Opel Kadet GSi", ngjyre te kuqe me targa te regjistrimit , i cili ishte i parkuar para ndërtësës, dhe te njëjtin ia shesin një personi ne Mitrovicën e Veriut.

Këso dore kane kryer veprën penale vjedhje e rende nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 31 te KP-së.

IV.me datën 01.01.2017 ne Prizren ne rrugën "Joni" me qellim te përvetësimit te kundërligjshëm per vete ose personin tjetër, ia marrin pasurinë e te dëmtuarit A^{..} S^{..}, ne ate mënyre qe me përdorimin e forcës thyejnë derën e lokalit – furrës "Oreks" hyjnë brenda dhe nga aty marrin para te metalta ne vlerë te papërcaktuar,

Këso dore kane kryer veprën penale vjedhje e rende nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 31 te KP-së.

V. me datën 08.01.2017, ne fshatin R^{..} K^{..} e St^{..}, me qellim te përvetësimit te kundërligjshëm per vete ose personin tjetër, ia marrin pasurinë e te dëmtuarit D^{..} K^{..}, ne atë mënyrë qe me përdorimin e forcës thyejnë derën e barnatores prone e te dëmtuarit, hyjnë brenda, dhe nga aty marrin barna te llojeve te ndryshme dhe largohen nga vendi i ngjarjes.

Këso dore kane kryer veprën penale vjedhje e rende nga neni 327 par.1 nen par.1.1 lidhur me nenin 31 te KP-së.

Pranohet marrëveshja për pranimin e fajësisë e lidhur ne mes te prokurorit te shtetit pranë Prokurorisë Themelore ne Prizren – Departamenti i përgjithshëm dhe te akuzuarve B^{..} R^{..} me mbrojtësin G^{..} K^{..} av. nga Peja dhe D^{..} B^{..} me mbrojtësin av. Z^{..} K^{..} av. nga Prizreni, PP./II.nr.3316-3/17 e dt. 28.04.2017.

Andaj gjykata bazuar ne nenin 41, 42, 43, 45, 46, 73, 74 , dhe neni 81 te KP-se, te akuzuarve iu i shqipton :

DËNIM ME BURG

Te akuzuarit B^{..} R^{..} ne kohëzgjatje prej 3 (tri) vite , duke i llogaritur kohën e kaluar në paraburgim, prej 10.02.2017 gjerë më 10.05.2017.

Te akuzuarit D^{..} B^{..} ne kohëzgjatje prej 3 (tri) vite ,

Si dhe

DËNIM ME GJOBE

Te akuzuarit B^{..} R^{..} duke i shqiptuar dënimin me te holla ne shume prej 500 (pesëqind) euro, të cilin dënim do ta paguaj ne xhirolllogarinë e kësaj gjykate, ne afatin prej 15 dite pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, e po qese dënnimi me te holla nuk mund te paguhet nga ana e te pandehurit ne afatin e sipërpërmendur, i njëjtë do te zëvendësohet me dënim burgu duke llogarite 20 euro , një dite burg qe do te thotë 25 dite burg.

JY

Te akuzuarit Dr. B... duke i shqiptuar dënimin me te holla ne shume prej 500 (pesëqind) euro, të cilin dënim do ta paguaj ne xhirollogarinë e kësaj gjykate, ne afatin prej 15 dite pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, e po qese dënim me te holla nuk mund te paguhet nga ana e te pandehurit ne afatin e sipërpërmendur, i njëjtë do te zëvendësohet me dënim burgu duke llogarite 20 euro , një dite burg qe don te thotë 25 dite burg

Te dëmtuarit S... G... T... nga Prizreni rr. Sezair Suroi nr.113, A... I... S... nga Prizreni rr. Hajdar Shala pn, Dr... Du... K... fsh. L... e Suharekës, F... Hy... Tel... nga Deqani, V... A... M... nga Prizreni rr. per realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest te rregullt civil.

Obligohen te pandehurit qe te i paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sa ato bëhen ne baze te llogarisë se gjykatës, , dhe ne emër te paushallit gjyqësor secili veç e veç te te paguajn shumen prej 50 euro, e te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nen kërcenim te ekzekutimit te dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.316-3/17 te dt. 02.05.2017, ndaj te akuzuarve B... R... D... By... nga Prizreni për shkak të veprës penale vjedhje e rende nga neni 327 par.1 nen par.1.1. lidhur me nenen 31 si dhe te akuzuarit Gani Elshani për shkak te veprës penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve te përfituar me kryerjen e veprës penale nga neni 345/1 te KP-së,

Prokuroria Themelore ne Prizren – Departamenti i përgjithshëm përkitazi lidhur me aktakuzën PP/II.nr.316/3-17 te dt.28.04.2017, me te akuzuarit B... R... me mbrojtësin av. G... K... si dhe te akuzuarin Dr... By... me mbrojtësin av... ! K... kane hyre ne marrëveshje për pranimin e fajësisë.

Pasi që sipas kësaj aktakuze ne cilësinë e te akuzuarit qëndron edhe i akuzuari G... E... nga Prizreni rr. De Rada , i cili akuzohet për veprën penale blerja , pranimi ose fshehja e sendeve te përfituar me kryerjen e veprës penale nga neni 345/1 te KP me te cilin prokuroria e shtetit nuk ka marrëveshje për pranimin e fajësisë gjyqtari gjykues ka bere veçimin e procedurës ndaj te akuzuarit G... El... dhe shqyrtimin e ka vazduar me te akuzuarit B... R... më dhe Dr... By... .

Në shqyrtimin e dt.11.05.2017 i mbajtur ne këtë çështje penale përkitazi për marrëveshjen e cekur me lartë gjykata bazuar ne nenen 233 te KPP-së, ka vlerësuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë i ka dëgjuar te akuzuarit ne prezencën e mbrojtësve te tyre , dhe ka konstatuar se pranimi është bere vullnetarisht nga ana e te akuzuarve pas konsultimeve te mjaftueshme me mbrojtësit e tyre .

Gjyqtari gjykues konstaton se janë përbushur të gjitha kushtet e parapara ligjore konform nenit 233 paragrafi 18 i KPP-së, andaj ka pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe pas përfundimit të dëgjimit në seancë ka shqiptuar edhe dënimin në suazat e marrëveshjes në mes të palëve.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë ne kuptim te nenit 450 dhe 452 të te KPKK-se.

Vendimi mbi udhëzimin në kontest te rregullt civil u mbështet ne neni 463/2 te KPP-së.

Më sa u tha më lartë u vendos si ne shqiptim të këtij aktgjykimi .

18

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

P.nr.921/17 të dt.11.05.2017

Procesmbajtësja:

Halime Nixha

Gjyqtari:

Refki Pira

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, mund të ushtrohet ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit ne Prishtine , e nëpërmjet të kësaj gjykate.